



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Ministarstvo Trgovine i Industrije
Ministry of Trade and Industry

Raporti vjetor

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

2012

21 Dhjetor, 2012

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive.....	3
1. Reformat e të Bërit Biznes	5
2. Struktura e re dhe rregullimi i brendshëm i MTI-së.....	5
3. Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik dhe bashkëpunimi me sektorin privat	6
4. Tregtia	7
5. Promovimi i Investimeve	8
6. Mbështetja e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme	9
7. Tregu i Brendshëm - Lëvizja e Lire e Mallrave	10
a. Metrologjia.....	10
b. Akreditimi.....	11
c. Standardizimi	12
d. Mbikëqyrja e Tregut.....	13
e. Mbrojtja e Konsumatorit	13
f. Industria	13
g. Te Drejtat e Pronësisë Industriale.....	14
h. Regjistrimi i Bizneseve.....	15
i. Turizmi dhe Rezervat Shtetërore	16
8. Ligjet.....	16
9. Planet dhe Objektivat për 2013	17

Përmbledhje ekzekutive

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e ka përmbyllur me sukses vitin 2012. Reformat e filluar vitin e kaluar kanë vazhduar përgjatë gjithë vitit 2012. Prej raportit e të bërit biznes, ri-strukturimit dhe organizimit funksional të MTI-së, përkrahjes së sektorit privat, e deri te përgatitjet për fillimin e procesit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit me Bashkimin Evropian, MTI ka vazhduar reformat strukturore, funksionale dhe të politikave. Viti 2012 kishte për qëllim implementimin e këtyre objektivave dhe përgatitjen për sfidat e vitit 2013.

Në vitin 2012, Kosova ka shënuar progres të ndjeshëm në Raportin e Bankës Botërore e të Bërit Biznes. Kosova përmirësuar treguesin e Fillimit të Biznesit për 44 vende në krahasim me vitin e kaluar. Treguesi për Lejet e Ndërtimit është përmirësuar për 33 vende, ndërkohë që përmirësimet më të mëdha janë bërë te Mbrojtja e Investitorëve ku Kosova ka lëvizur pozitivisht për 76 vende. Qasja në Rrymë Elektrike është përmirësuar për 6 vende, Pagesa e Taksave për 4, Tregtia Ndërkufitare është përmirësuar për 9 vende, ndërsa Zbatimi I Kontratave për 1 vend.

Në vazhden e reformës së administratës publike, është ridizajnuar struktura e re e funksionimit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, si dhe është hartuar rregullorja për funksionalizimin e kësaj strukture e cila është miratuar nga Qeveria e Kosovës. Ndërkohë, me iniciativën e Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik (KKZHE), të udhëhequr nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, janë iniciuar një sërë reformash dhe të cilat kanë për qëllim përmirësimin e ambientit të biznesit, forcimin e sektorit privat, si dhe rritjen e qëndrueshme ekonomike.

Departamenti i tregtisë në MTI është duke i forcuar kapacitetet për të qenë i gatshëm të përballet me sfidat e reja nga procesi i Stabilizim Asociimit dhe negocimin e marrëveshjeve tregtare me vendet tjera. MTI ka filluar negocimin e Marrëveshjes për Tregtinë e Lirë me Turqinë dhe ka identifikuar mallrat dhe shërbimet sensitive. Është përgatitur analiza që parasheh efektin ekonomik të Marrëveshjes së Tregut të Lirë me BE-në ndërkohë që janë janë shqyrtuar dhe zgjidhur raste të ndryshme të dëmtimit të tregut në Kosovë nga kompanitë e huaja dhe nga distributoret kosovarë.

Agjencia për Promovim të Investimeve në Kosovë (APIK) ka organizuar 13 konferenca për investitorë të jashtëm në vitin 2012. Në këto konferenca kanë marrë pjesë mbi 500 investitorë të huaj potencial të interesuar për të investuar në Kosovë. MTI ka realizuar reklama me Kompaninë Mediale CNN me qëllim të promovimit të Turizmit Vendor dhe promovimin e Kosovës si vend i përshtatshëm për investime.

Është finalizuar Plani i Veprimit të Strategjisë së zhvillimit të NVM-ve. AMNVM-ve në Mars organizoi ceremoninë e nënshkrimit të kontratave për 12 biznese të reja dhe 4 biznese

ekzistuese për zgjerim për vendosje në Parkun e Biznesit në Drenas (PBD), gjithsej 16 biznese. Në bashkëpunim me MASHT dhe OECD është në përfundim hartimi i Strategjisë së Inovacioneve 2013-2017. MTI ka vendosur për krijimin e Zonës ekonomike “Parku i Biznesit në Mitrovicë.

Departamenti i Metrologjisë së Kosovës (DMK) ka nënshkruar dy Memorandume Bashkëpunimi të rëndësishme, me Shqipërinë dhe Turqinë. Drejtoria e Akreditimit të Kosovës (DAK) në vitin 2012 ka vazhduar me plotësimin e legjislacionit dhe kryerjen e para-vlerësimeve dhe mbikëqyrjeve. Agjencia Kosovare e Standardizimit (AKS) gjatë vitit 2012 ka adoptuar gjithsej 691 Standarde Evropiane dhe Ndërkombëtare, në Standarde Kosovare.

MTI ka punuar në futjen e zyrave regjionale të inspektimit të tregut nën ombrellën e MTI-së. Inspektorati i tregut ka përmirësuar bashkëpunimin me trupat për vlerësim të konformitetit për karburantet e lëngëta të naftës. Me rregulloren e re të MTI-së, mbrojtja e konsumatorit është themeluar si njësi e veçantë. Ndwrkaq, Zyra për të Drejtat e Pronësisë Industriale (ZPI) gjatë vitit 2012 përmes protokollit të ZPI-se janë pranuar 11,220 kërkesa të llojeve të ndryshme për objekte të pronës industriale.

Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK) ka vazhduar procesin e shkurtimit të procedurave, kohës së regjistrimit të biznesit dhe hapjen e qendrave të rejë nëpër Kosovë. Departamenti i Turizmit ka vazhduar me licencimin e Agjencive Turistike dhe klasifikimin e objekteve hoteliere, me ç’rast janë licencuar 19 agjenci. Ndwrkohw, Kosova tanimë ka për herë të parë rezervat e para shtetërore të grurit.

Aktivitetet e MTI-se gjatë vitit 2012 po ashtu kanë përfshirë reforma në legjislacion, me c’rast janë përmirësuar dhe aprovuar në Kuvend: Ligji për Metrologjinë, Ligji për Metalet e Çmuara, Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit, Regjistrimin e Pengut në Regjistër. Ndërsa në procedurë të ndryshimit e të cilat janë aprovuar në Qeveria janë Ligji për Zonat Ekonomike, Ligji për Turizmin, Ligji për Produktet e Ndërtimit, dhe Investimet e Huaja.

Planet e MTI-së për 2013 përfshijnë: Përmirësimin e ambientit të të bërit biznes, Mbështetjen e NVM-ve dhe Promovimin e Investimeve, një mekanizmi financiar që lehtëson koston e bizneseve, vazhdojë negocimin e Marrëveshjeve tjera për Promovim dhe Mbrojtje të Investimeve me vendet tjera, Përmirësimi i Politikave Tregtare, përmirësimin e Lëvizjes së Lire të Mallrave, përmirësimi i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

1. Reformat e të Bërit Biznes

Kosova ka shënuar progres të ndjeshëm në Raportin e Bankës Botërore e të Bërit Biznes. Pas disa viteve të rënies së vazhdueshme në ranglistë, Kosova ka shënuar ngritje për 28 vende, ngritja më e larta në rajon për këtë vit.

Kosova përmirësuar treguesin e Fillimit të Biznesit për 44 vende në krahasim me vitin e kaluar. Treguesi për Lejet e Ndërtimit është përmirësuar për 33 vende, ndërkohë që përmirësimet më të mëdha janë bërë te Mbrojtja e Investitorëve ku Kosova ka lëvizur pozitivisht për 76 vende. Qasja në Rrymë Elektrike është përmirësuar për 6 vende, Pagesa e Taksave për 4, Tregtia Ndërkufitare është përmirësuar për 9 vende, ndërsa Zbatimi I Kontratave për 1 vend.

2. Struktura e re dhe rregullimi i brendshëm i MTI-së

Në vazhden e reformës së administratës publike, është ridizajnuar struktura e re e funksionimit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, si dhe është hartuar rregullorja për funksionalizimin e kësaj strukture e cila është miratuar nga Qeveria e Kosovës. Struktura ndër të tjera i ka mundësuar MTI-se të krijoj Mbrojtjen së Konsumatorit dhe Mallrat Strategjike si dhe atë për Rezerva të Obliguara të Naftës si njësi të veçantë, ndërsa shërbimet e përbashkëta siç janë financat, janë vendosur nën Administratën Qendrore. Metrologjia, Pronësia Industriale dhe Inspektorati i Tregut janë ngritur në nivel të Agjencive. Është krijuar Agjencia e re për Mbështetjen e Zhvillimit të Sektorit Privat duke i shkrirë atë të Promovimit të Investimeve dhe atë të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme. Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve dhe funksionalizimit të strukturës së re, nga viti i kaluar, numri i zyrtarëve të rekrutuar nga skema Young Cell ka arritur në 13.

Në funksion të avancimit të politikave dhe reformës administrative, **MTI ka hartuar Planin Zhvillimor Strategjik 2012-2014, i cili është miratuar nga Komisioni Ndërmnistror për Reformë të Administratës Publike në Korrik të këtij viti.** Në këtë drejtim, MTI ka hartuar edhe Strategjinë Sektoriale 2013-2017, me fokus në Zhvillimin e Industrisë dhe Avancimin e Politikave Tregtare. Strategjia përfshirë planin e veprimit, është në fazën finale të hartimit e cila përveç tjerash parasheh ngritje të kapaciteteve dhe avancim në Politikat Tregtare dhe ato të Sektorit Privat, reforma të mëtejshme në strukturim të ministrisë dhe përafrim të legjislacionit.

MTI ka zhvilluar projekte për IPA 2012 dhe IPA 2013, me ç ‘rast ka përfituar shumë prej €10,750,000, prej të cilave nga Komisioni Evropian MTI ka përfituar €9,250,000. Projektet prej

të cilave përfiton MTI mbështesin përmirësimin e Lëvizjes së Lirë të Mallrave përfshirë avancimin e Infrastrukturës së Cilësisë dhe avancimin e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Mbikëqyrjes së Tregut. Ndërkaq në mbështetje të zhvillimit të sektorit privat MTI mbështetet MTI përfiton në zhvillimin e mëtejshëm të Politikës Tregtare, rritjes së konkurrueshmërisë, promovim të eksportit dhe grante për NVM-të.

3. Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik dhe bashkëpunimi me sektorin privat

Me iniciativën e Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik (KKZHE), të udhëhequr nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, janë iniciuar një sërë reformash dhe të cilat kanë për qëllim përmirësimin e ambientit të biznesit, forcimin e sektorit privat, si dhe rritjen e qëndrueshme ekonomike. Brenda një periudhe 8 mujore KKZHE-në është shndërruar në një mekanizëm të fuqishëm i cili promovon reformat zhvillimore dhe ndihmon zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Kosovës.

KKZHE ka hartuar dhe aprovuar “Platformën e politikave të zhvillimit ekonomik 2012-2014,” bazuar në Planin e Veprimit të Vizionit Ekonomik të Kosovës 2012-2014 që detajon 5 prioritetet e qeverisë së Republikës së Kosovës. KKZHE ka iniciuar reformën në Sistemin e Licencave dhe Lejeve dhe një ligji ombrellë. Ne tashmë kemi listën me të gjitha licencat dhe lejet të lëshuara në nivel qendror dhe po ashtu kemi hartuar edhe Projektligjin ombrellë për Licencat dhe Lejet.

Këshilli ka iniciuar edhe ndryshimin e Ligjit të Festave Zyrtare që është dërguar në qeveri për aprovim. Po ashtu, KKZHE ka iniciuar edhe ndryshimin e Ligjit të Punës i cili tashmë është futur në procedurat e amandamentimit. KKZHE ka diskutuar dhe aprovuar idenë e MTI-së për Blerjen e Produkteve Kosovare në Kontrata Publike dhe besoj që shumë shpejt do të ndërmarrim edhe hapat tjerë konkret siç është krijimi i grupit punues dhe ndryshimi i ligjit për prokurim publik në mënyrë që të jetësohet kjo ide dhe të bëhet e mundur blerja e produkteve vendore në kontratat publike.

Këshilli ka bërë të mundur që të thellohet dhe të intensifikohet edhe më tepër dialogu publiko-privat me komunitetin e biznesit. Është i pakontestueshëm fakti se KKZHE tashmë po shërben edhe si forum ku alternativat politike shtjellohen me palët e interesuara dhe ku dëgjohet zëri i komunitetit të biznesit dhe partneriteti me sektorin privat po rritet. Në KKZHE janë diskutuar politikat bujqësore, politikat minerare, pakoja e re fiskale, fiskalizimi i bizneseve, Sistemi Gjyqësor i Kosovës dhe efektet e tij në kredi-dhënie/qasjen në financa, dhe çështjet me të cilat ballafaqohen industritë në Kosovë.

4. Tregtia

Departamenti i tregtisë në MTI është duke i forcuar kapacitetet për të qenë i gatshëm të përballet me sfidat e reja nga procesi i Stabilizim Asociimit dhe negocimin e marrëveshjeve tregtare me vendet tjera. MTI ka qartësuar pozicionin dhe kërkesën e Komisionit Evropian se me fillimin e negociatave për MSA nuk do të ketë negociata të ndara tregtare me Kosovën. Tregtia nuk do të negociohet e ndarë sikur në rast të Marrëveshjes së Lirë Tregtare, por ajo do të jetë pjesë e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit. Çështjet e MSA-së që kanë lidhje me tregtinë do të vazhdojnë të koordinohen nga MTI. Brenda strukturave ekzistuese MTI do të jetë përgjegjëse për të gjitha aspektet tregtare të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

MTI ka filluar negocimin e Marrëveshjes për Tregtinë e Lirë me Turqinë. Takimi i parë është mbajtur në Ankara, në Shtator të këtij viti, ndërsa i radhës pritet të mbahet Shkurt. MTI është duke i identifikuar mallrat dhe shërbimet sensitive, që kanë nevojë të mbrohen. Sa i përket përgatitjes për negocimin e marrëveshjes së Tregtisë së Lirë me BE-në, është ristrukturuar Departamenti i Tregtisë, i cili është funksionalizuar dhe është duke punuar sipas formatit të ri.

Është përgatitur analiza që parasheh efektin ekonomik të Marrëveshjes së Tregut të Lirë me BE-në. Analiza tregon gjendjen aktuale të ekonomisë dhe efektet e mundshme të liberalizimit të tregtisë me BE-në. Kjo analizë do të mundësojë që vendimet të arrihen bazuar në avantazhet krahasuese të Kosovës, shkallën e ndjeshmërisë së produkteve të tregtuara, dhe ndikimet tregtare, ekonomike dhe financiare të liberalizimit të tregtisë.

Pas kryesimit të CEFTA-se në vitin 2011, gjatë vitit 2012 MTI ka vazhduar me pjesëmarrjen e rregullt në CEFTA. Sekretariatit të CEFTA-se ju është dërguar kërkesë lidhur me rastet e ndryshme të shkeljes së kësaj marrëveshjeje si, rasti i kuotave për miellin kosovar në Maqedoni, akciza për verërat dhe pijet alkoolike si dhe produktet e birrës nga ana e Shqipërisë. Nga ky veprim ka rezultuar në heqjen e kuotave nga ana e Maqedonisë.

Në Departamentin e Tregtisë janë rekrutuar 4 zyrtar të rinj me përvojë dhe përgatitje akademike superiore. Po ashtu, me qëllim të përgatitjes për negocim të marrëveshjeve tregtare zyrtarët kanë marrë pjesë në trajnime të vazhdueshme që nga Janari. **Është dizajnuar dhe është në funksion baza e të dhënave për shkëmbime tregtare.** Po ashtu, është formuar edhe grupi për negocimin e marrëveshjes së tregtisë libre me Turqinë.

Me qëllim të koordinimit më të mirë të politikave të tregtisë janë funksionalizuar pesë nëngrupet për politika tregtare si ai për Shërbime, Lehtësim të Tregtisë, Bujqësi, Industrisë, dhe Marrëveshje Tregtare dhe grupi Punues për Politika Tregtare.

Janë shqyrtuar raste të ndryshme të dëmtimit të tregut kosovare nga kompanitë e huaja dhe nga distributoret kosovarë. Ka pas raste të ndryshme të dumpingut dhe të dëmtimit substancial të tregut kosovarë cilat janë paraqitur nga kompanitë kosovare në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Këto raste janë trajtuar në bazë të ligjeve në fuqi.

Rasti i parë i këtillë ka te bëjë me mbrojtjen e Industrisë së Shpeztarisë nga Importi i mishit te zogut nga Republika e Sllovenise, konkretisht nga Kompania “Perutnina” nga Ptuji. Në bazë të kërkesës së kompanisë kosovare “Konsoni”, bazuar në ligjet në fuqi në Kosovë, është zgjidhur rasti. **Rasti i dytë kishte të bënte me mbrojtjen e tregut të çimentos nga importet.** Në bazë të Ligjit për Masa Mbrojtëse, është marrë vendimi i përkohshëm për masat e mbrojtjes në importe, me një tarifë doganore prej 35%. Këto masa kanë zgjatur 50 ditë, nga data 11.06.2012 deri me datën 01.08.2012, pas së cilës nga Departamenti i Tregtisë është bërë një rivlerësim i tregut të çimentos, me ç’rast është shfuqizuar vendimi paraprak. **Rasti i tretë ishte ai i tregut te mishit të pulës nga Sllovenia, ku pas analizave është vërejtur se ka pasur rast të dumpingut.** Si rrjedhojë, Departamenti i Tregtisë duke zbatuar ligjin anti-dumping ka ngritur bazën doganore lidhur me importin e këtij produkti. Rasti i katërt, kishte të bënte me mbrojtjen e materialit ndërtimorë nga importi i bllokave të tipit “ytong” (produkt i ngjashëm me siporeksin), Serbia. Masa është vendosur në bazë të kërkesës së kompanisë Kosovare “UNICOMERC” nga Kaçaniku. Me këtë rast është rritur baza doganore, nga 25.00 € për m³ në 40.00 € për m³. Kjo masë mbrojtëse është ende në fuqi.

Po ashtu, janë përpiluar Listat për Eksport dhe Import për vitin 2011 për produktet me kod 8 shifror, me ç’rast janë paraqitur të dhënat për detyrimet doganore, akciza, TVSH dhe vlera e importuar/eksportuar si për BE ashtu edhe për Turqinë.

Ka filluar krijimi i bazës së të dhënave për shërbime, për nevojat e Ministrisë se Tregtisë dhe Industrisë. Kjo bazë e të dhënave do të jetë shumë e nevojshme për hartimin e politikave tregtare lidhur me shërbimet. Kjo shërben për përmirësimin e të dhënave statistikore, identifikimin e legjislacionit lidhur me shërbimet, krijimin e të dhënave për bizneset shërbyese dhe sektorët prioritar dhe identifikimin e barrierave në tregtinë e shërbimeve.

5. Promovimi i Investimeve

Agjencia për Promovim të Investimeve në Kosovë (APIK) ka organizuar 13 konferenca për investitorë të jashtëm në vitin 2012. Në 10 prej tyre kanë marrë pjesë mesatarisht rreth 25 biznese kosovare për çdo konferencë. Bizneset vendore kane pasur mundësi te takohen me biznese te shteteve te përmendura, me qellim te krijimit te partneritetit për biznes. Është e rëndësishme të potencohet që **në këto konferenca kanë marrë pjesë mbi 500 investitorë të huaj potencial të interesuar për të investuar në Kosovë.** Këto konferenca janë mbajtur në

Paris, Bursa, Budapest, dhe Berlin; ndërsa për të njëjtin qëllim janë mbajtur forume biznesi si ai Italo-Kosovar, Zvicerrano-Kosovar, Turko-Kosovar, dhe Franko-Kosovar.

Organizimi i këtyre konferencave ka dy qëllime: përmirësimin e imazhit të Kosovës, pra promovimin e Kosovës si vend stabil, si dhe tërheqjen e investimeve të huaja, duke prezantuar potencialin e vendit tonë për investitorë. Nga këto konferenca tanimë i kemi parë edhe rezultatet konkrete, ku disa kompani kanë filluar bashkëpunimin me kompani të huaja. Po, ashtu edhe gjatë këtij viti APIK ka nënshkruar 2 marrëveshje për mbrojtjen dhe promovimin e investimeve me Zvicrën dhe Turqinë ndërsa afër firmosjes janë marrëveshjet me Maqedoninë, Kroacinë, Malin e Zi dhe Shqipërinë. MTi është në fazën fillestare të arritjes së marrëveshjes me Kuvajtin, San Marinon dhe Japoninë.

MTI ka realizuar reklama me Kompaninë Mediale CNN me qëllim të promovimit të Turizmit Vendor dhe promovimin e Kosovës si vend i përshtatshëm për investime. Është nënshkruar marrëveshja me Agjencinë për Promovimin e Investimeve në Hungari, që ka për qëllim shkëmbimin e eksperiencave në këtë fushë, ndërkohë që janë publikuar dy materiale të reja promovuese që e promovojnë Kosovën si një vend të përshtatshëm për të bërë biznes.

6. Mbështetja e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme

Gjatë këtij viti Agjencia për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (AMNVM) ka punuar në ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve bazike për mbështetje të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) si Ligji Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme dhe Ligji për Zonat Ekonomike. Dy ligjet tani janë të aprovuara në Qeveri dhe janë proceduar për aprovim në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Po ashtu, me qëllim të përmirësimit të planifikimit **është finalizuar Plani i Veprimit të Strategjisë së zhvillimit të NVM-ve**, i cili është inkorporuar në strategjinë e MTI-se për Zhvillimin e Sektorit Privat.

AMNVM-ve në Mars organizoi ceremoninë e nënshkrimit të kontratave për 12 biznese të reja dhe 4 biznese ekzistuese për zgjerim për vendosje në Parkun e Biznesit në Drenas (PBD), gjithsej 16 biznese. Vlera e investimit të deklaruar nga këto biznese është €15,362,000.00 dhe 358 të punësuar. Po ashtu, është ndërtuar rrjeti energjetik dhe i trafo-stacionit të PBD-së që vënë në funksion në Korrik. Në Mars ka filluar projekti Hartimi i Strategjisë së Inovacioneve në Kosovë. Projekti është në bashkëpunim me MASHT, përderisa implementohet nga OECD dhe i financohet nga Komisioni Evropian.

Me qëllim të përmirësimit të Dialogut Publiko-Privat dhe fuqizimit të ndërmarrësisë, AMNVM në partneritet me 25 institucione publike dhe private organizoi kampanjën Ditët e Biznesit të Vogël 2012 (DBV '12). Në kuadër të këtij projekti është realizuar fushata e fuqizimit të ndërmarrësve dhe është shpallur Top NVM-ja më konkurrenente në konferencat e Ceremonive të çmimeve në të 5 rajonet e Kosovës si dhe në nivel kombëtar. Në bashkëpunim me Ballkan Institute është realizuar shkolla e ndërmarrësisë për 5 të rinj kosovar te cilët tanimë i kane firmos edhe kontratat.

Janë kryer hulumtime mbi gjendjen e NVM-ve në Kosovë. Këto hulumtime përfshijnë pasqyrat statistikore për NVM-të” për gjashtëmujorin e parë të 2012, studimin mbi qasjen e NVM-ve në financa, studimin mbi inkubatorët në Kosovë dhe analizën e trajnimeve të NVM-ve. Në bashkëpunim me Shoqatën e Eksportuesve të Kosovës është realizuar aktiviteti “Top Eksportuesi i Vitit 2012”.

Në bashkëpunim me MASHT dhe OECD është në përfundim hartimi i Strategjisë së Inovacioneve 2013-2017. Agjencia e NVM-ve përmes projektit “Mbështetja e NVM-ve përmes MTI-së” ka përfunduar “Analizën e Nevojave të Trajnimeve për NVM-të”, dhe në bazë të kësaj analize ka filluar projekti i konkurrueshmërisë në 5 rajonet e Kosovës. Ky projekt planifikohet të vazhdohet me donatorët edhe vitin e ardhshëm. **Në korrik të këtij viti në Parkun e Biznesit në Drenas, ka përfunduar ndërtimi dhe është në lëshuar në funksion trafostacionit 35/10 Kv.**

MTI ka vendosur për krijimin e Zonës ekonomike “Parku i Biznesit në Mitrovicë”. Parku i Biznesit në Mitrovicë, gjatë vitit 2012 ka filluar me përgatitjen e dokumentacionit për legalizim të tij. Me datë 17/10/2012 me vendim të Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Kosovës është Parku i Biznesit në Mitrovicë është shpallur Zonë ekonomike.

7. Tregu i Brendshëm - Lëvizja e Lire e Mallrave

a. Metrologjia

Departamenti i Metrologjisë së Kosovës (DMK) ka nënshkruar dy Memorandume Bashkëpunimi të rëndësishme, me Shqipërinë dhe Turqinë. Në kuadër të funksionalizimit të mëtejme të Laboratorëve të Metrologjisë dhe përmirësimit të bashkëpunimit me vendet tjera, në Korrik 2012 (17.07.2012) është nënshkruar Memorandumi i Bashkëpunimit me Institutin e Metrologjisë TUBITAK-UME nga Turqia dhe është përgatitur plani i veprimit për realizimin e veprimeve të dala nga ky memorandum që nënkupton mundësinë e shkëmbimit të përvojave

dhe shtimit të kapaciteteve teknike në mes të dy palëve. Gjithashtu me 26 Nëntor të vitit 2012, në Tiranë, është nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë së Shqipërisë.

Departamenti i Metrologjisë ka kompletuar laboratorin për madhësi elektrike me sistemin matës për testimin e njehsorëve elektrik, si dhe komparatorin me klasë të lartë të saktësisë 0.01, për kalibrimin e sistemit matës dhe etalonëve referent. Në kuadër të këtij projekti është certifikuar stafi për testim dhe kalibrimin e njehsorëve dhe etalonëve referent-punues. Po ashtu, është punuar në përgatitjen e dokumentacionit për vendosjen e sistemit të cilësisë në DMK, respektivisht për përgatitjen e dy laboratorëve për akreditim (masë dhe termometri) të cilat do t'i nënshtrohen vlerësimit të konformiteteve nga Drejtoria e Akreditimit deri në fund të Dhjetorit.

Është certifikuar stafi për testimin, verifikimin e njehsorëve elektronik dhe induktiv. Si dhe vlen të ceket që pas disa viteve për herë të parë është bërë i mundur kalibrimi i etalonëve të Metrologjisë. Zyrtaret punëtor në laboratorët e metrologjisë janë trajnuar për termometri, madhësi elektrike, vëllim, rrjedhje dhe forcë.

Në vazhdim të plotësimit të legjislacionit sekondar janë miratuar Udhëzimet Administrative si në vijim:

1. Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2012, Për lartësinë dhe mënyrën e pagesës për shërbimet në metrologji;
2. Udhëzimi Administrativ Nr. 16/2012, Për kushtet metrologjike për gramarët etalon me masë nominale 50 kg deri 5000 kg;
3. Udhëzimi Administrativ Nr. 17/2012, Për kushtet metrologjike për gramarët me masë nominale 1 mg deri 50 kg

b. Akreditimi

Drejtoria e Akreditimit të Kosovës (DAK) në vitin 2012 ka vazhduar me plotësimin e legjislacionit dhe kryerjen e para-vlerësimeve dhe mbikëqyrjeve. Është amandamentuar Udhëzim Administrativ nr. 2008/19 për caktimin e Përmbajtjes dhe Përdorimit të Emblemës së Akreditimit. DAK janë kryer tri para-vlerësime, shtatë vlerësime (pas së cilave ka pësuar dhënia e akreditimit) si dhe janë realizuar dymbëdhjetë mbikëqyrje. Me kërkesën e departamentit të Industrisë janë kryer edhe katër vlerësime për Autorizim nga MTI-ja, dy prej të cilave ishin Laborator Testues dhe dy Trupa Inspektues. Gjithashtu, është kryer një zgjerim i fushës së akreditimit të Laboratorit për Kontrollin e Cilësisë së Produkteve Farmaceutike - Fabrika "Trepharm". Ndërsa, kanë aplikuar për akreditim 11 Trupa për Vlerësimin e Konformitetit.

Stafi i DAK-ut është trajnuar me ndihmën e projektit PTB (Instituti Gjerman i Metrologjisë). Janë mbajtur gjithsejtë gjashtë trajnime me nga dy pjesëmarrës. Nga ana e DAK për përfaqësuesit e Trupave të Vlerësimit të Konformitetit janë mbajtur katër trajnime (dy në standardin SK ISO/IEC 17025 dhe dy në standardin SK ISO/IEC 17020) me gjithsej 63 pjesëmarrës. Po ashtu janë kryer procedurat e rishikimit të dokumentacionit sipas kërkesave të standardit SK ISO/IEC 17011.

Drejtoria e Akreditimit e Kosovës (DAK) gjatë kësaj periudhe ka zgjedhur të gjitha jo-konformitetet e gjetura nga vlerësues të Asociacionit Evropian të Akreditimit (European co-operation for Accreditation), dhe së shpejti pritet që komiteti i EA-së për Marrëveshje Multilaterale (EA-MLA) të merr vendim për vlerësimin e plotë të Drejtorisë së Akreditimit. Rezultat i vlerësimit është njohja e certifikatave të vlerësimit të konformitetit të lëshuara nga ana e Trupave të Vlerësimit të Konformitetit të akredituara nga DAK.

c. Standardizimi

Agjencia Kosovare e Standardizimit (AKS) gjatë vitit 2012 ka vazhduar me plotësimin e bazës ligjore dhe adoptimin e standardeve të reja. AKS ka plotësuar bazën nënligjore duke draftuar Udhëzimin Administrativ nr. 02/2012 për Këshillin Profesional të Standardizimit dhe gjatë kësaj periudhe janë adoptuar gjithsej 691 Standarde Evropiane dhe Ndërkombëtare, në Standarde Kosovare. Standardet e adoptuara përfshijnë teknologjisë agroushqimore (61 standarde), energjisë (21), transportit dhe shërbimeve postare (170), përpunimit të drurit (68), pajisjet mbrojtëse personale (19), derivate të naftës dhe gazit (103), makineri (107), plastikë, metale dhe elektrikë (130) dhe pajisje sportive dhe rekreacion (12).

Në Shkurt të këtij viti është përgatitur dhe nënshkruar udhëzimi administrativ i cili rregullon Këshillin Profesional të Standardizimit. Në vazhden e promovimit të standardeve, është publikuar katalogu i standardeve (format i shtypur dhe elektronik); është organizuar manifestimi i Ditës Botërore të Standardeve; AKS ka marrë pjesë në forume ndërkombëtare dhe po ashtu është përçar mesazh përmes medieve lokale. **AKS është duke u hartuar koncepti i bazës së të dhënave për standardet, në mbështetje të projektit të USAID-it.**

d. Mbikëqyrja e Tregut

Në bazë të ligjit për Inspektoratin e Tregut dhe me qëllim të ngritjes së kapaciteteve dhe ngritjes së efektivitetit në mbikëqyrjen e tregut MTI ka punuar në futjen e zyrave regjionale të inspektimit të tregut nën ombrellën e MTI-së. MTI ende është në negociim për arritjen e një Memorandum Mirëkuptimi me Komunitet e Kosovës.

Inspektorati i tregut ka përmirësuar bashkëpunimin me trupat për vlerësim të konformitetit për karburantet e lëngëta të naftës, duke vazhduar monitorimin e cilësisë së karburanteve në pikat doganore dhe në tregun e brendshëm. Po ashtu, me sukses kontrollohet çdo import i këtij produkti në pikat doganore. Kurse bazuar në planin e monitorimit të cilësisë për karburantet e lëngëta të naftës, në tregun e brendshëm bëjmë monitorimin e deponive të importuesve këtu në pikat shitëse me shumicë dhe pakice.

e. Mbrojtja e Konsumatorit

Me rregulloren e re të MTI-së, mbrojtja e konsumatorit është themeluar si njësi e veçantë, e cila si e tillë ka vazhduar me aktivitete në ngritjen e vetëdijes së konsumatorëve. Aktivitetet janë përcjellë me spote në mediat vendore; punëtori në universitete; tryeza të hapura të diskutimit; u janë dërguar mesazhe telefonike konsumatorëve, si dhe janë shpërndarë material promovues. Si rezultat, **numri i ankesave të konsumatorëve ka shënuar rritje 70-80% , krahasuar me vitin 2011.**

MTI ka plotësuar ligji aktual për mbrojtje të konsumatorit, dhe si i tillë është aprovuar në Kuvend dhe ka hyrë në fuqi në afatin e paraparë. Ligji i ri përveç tjerash rregullon çështjet si: kreditë e konsumatorëve, kontratat në largësi, praktikën mashtruese, praktikën agresive, ofertat publike, shitja me aksion, dhe shitja e mallrave me defekt. Po ashtu, **ka vazhduar punën Këshilli për Mbrojtje të Konsumatorit i drejtuar nga MTI.** Do të vazhdojë të funksionoj linja e thirrjeve pa pagesë 0800 1100, tanimë e kontraktuar edhe për dy vite të tjera.

f. Industria

Me qëllim të përmirësimit të Cilësisë së Karburanteve të Lëngëta të Naftës dhe kërkesave të ISO standardeve, dhe bazuar në raportin e Komisionit për vlerësimin e kushteve për dhënie të propozimit për autorizimin e trupave për vlerësim të konformitetit për mënyrën e autorizimit të Trupave për Vlerësim të Konformitetit, MTI ka autorizuar laboratorët: Sierra-Lab Sh.P.K

Prishtinë dhe Kosova – Lab Sh.A si dhe është në procedurë të autorizimit trupën Inspektuese Saybolt Pan Adratika O.O.O. Po ashtu, është duke u punuar në funksionalizimin e Qendrës së Panaireve, Laboratorit të Industrisë Kimike dhe Institutit të Produkteve të Ndërtimit. Është duke u punuar në funksionalizimin e Qendrës së Panaireve, Laboratorit të Industrisë Kimike dhe Institutit të Produkteve të Ndërtimit

Në funksion të zbatimit të ligjit për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të konformitetit 04/L-039 dhe në bazë të planit të punës së Qeverisë janë ri draftuar dhe miratuar këto akte nënligjore:

- Rregullore nr. 12/ 2012 mbi metodat e analizave kuantitative të përzierjeve dy komponentësh të fibrave të tekstilit
- Rregullore nr. 11/ 2012 për përmbajtjen e lëndës së parë dhe emërtimet e tekstilit,
- Rregullore nr. 10/ 2012 për etiketimin e materialeve të pjesëve kryesore të mbathjeve të dedikuara për shitje konsumatorëve
- Rregullore Nr. 09/ 2012 për Ashensorët dhe Komponentët e Tyre të Sigurisë
- Rregullore Nr. 08/ 2012 për Pajisjet Personale Mbrojtëse
- Rregullore Nr. 07/ 2012 për Pajtueshmërinë Elektromagnetike (EMC)
- Rregullore nr. 06/2012 për Pajisjet me Gaz
- Rregullore nr. 05/2012 për Teleferikët Për Bartjen E Njerëzve
- Rregullore nr. 04/2012 për Produktet Nga Qelqi I Kristaltë
- Rregullore nr. 03/ 2012 për Sigurinë E Lodrave
- Rregullore nr. 1/2012 për Metodën e Analizës Sasiore të Përzierjeve tre Komponentë të Fibrave të Tekstilit.

g. Te Drejtat e Pronësisë Industriale

Zyra për të Drejtat e Pronësisë Industriale (ZPI) përgjatë vitit 2012 ka ngritur kapacitetet administrative dhe vazhduar me procesimin e patentave, markave tregtare dhe dizajnit industrial. Ka vazhduar punën Këshilli për Pronësi Intelektuale i cili tanimë ka edhe planin e punës.

Ne implementim të Ligjit për Marka Tregtare është nënshkruar udhëzimi administrativ për ekzaminimin e përkohshëm të aplikacioneve për mbrojtjen e markave tregtare. Po ashtu, ne zbatim të ligjeve ne fuqi janë hartua dhe miratua edhe udhëzimet ne vijim:

1. UA për kompetencat, mandatin dhe punën e Komisionit të ankesave në Zyrën e Pronësisë Industriale, nënshkruar në Qershor
2. Udhëzimi Administrativ për Procedurat e regjistrimit të Patentave nënshkruar në Korrik

3. UA për Regjistrimin e Dizajnit Industrial, nënshkruar ne Gusht
4. UA për tarifatat administrative te regjistrimit te objekteve te pronësisë industriale, nënshkruar ne Gusht
5. UA për regjistrimin e Markës Tregtare, nënshkruar ne Gusht
6. UA për Tarifatat Administrative të Regjistrimit të Objekteve të Pronës Industriale

Gjatë vitit 2012 përmes protokollit të ZPI-se janë pranuar 11,220 kërkesa të llojeve të ndryshme për objekte të pronës industriale janë sistemuar dhe janë regjistruar në bazën e të dhënave të gjitha. Ndërsa, me qëllim të ngritjes së vetëdijes së bizneseve për rëndësinë e pronës industriale ZPI ka organizuar një varg seminaresh në disa qendra të Kosovës me teme “Rëndësia e mbrojtjes së Pronës Industriale për Bizneset”, me pjesëmarrjen e Doganave të Kosove dhe të OEK.

h. Regjistrimi i Bizneseve

Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK) ka vazhduar procesin e shkurtimeve të procedurave, kohës së regjistrimit të biznesit dhe hapjen e qendrave të rejë nëpër Kosovë. Është rinovuar qendra për regjistrim te bizneseve, sipas standardeve bashkëkohore. Numri i sporteleve është shtuar dhe tashmë shërbimet ofrohen më shpejt dhe ne mënyrë transparente. Ne kuadër të kësaj qendre tani përveç regjistrimit të biznesit ofrohen edhe shërbime të tjera si: pajisja me marka tregtare, licencat për derivatet e naftës, licencat e turizmit dhe licencat për duhan. Gjate këtij viti janë hapur edhe katër qendra One Stop Shop nëpër Komunitatet e Kosovës si në Lipjan, Shtime, Graçanicë dhe Fushë Kosovë, duke ngritur numrin total në 26 qendra.

Në bashkëpunim me ATK-ne dhe Doganat ARBK ka integruar dhe konsoliduar sistemin e regjistrimit dhe ka harmonizuar procedurat e regjistrimit të biznesit. Kjo mundëson që bizneseve të ju ofrohen shërbimet në një vend që do të thotë përpos certifikatës së biznesit do të mundësohet pajisja me numër fiskal, regjistrim vullnetar për TVSH dhe certifikata për import - eksport për importuesit e vegjël, të gjitha këto në një vend të vetëm.

Procedurat e regjistrimit të bizneseve janë lehtësuar. Këto lehtësime përfshijnë eliminimin e lejes së punës nga komuna dhe eliminimin e nevojës për regjistrimin e kompanive pranë Doganave të Kosovës për import dhe eksport. Tani kompanitë përmes certifikatës së TVSH-se do t'i kryejnë aktivitetet për eksport/import; marrja e certifikatës së TVSH-se nga 10 është shkurtime në vetëm 1 ditë. Sa i përket numrit të bizneseve të regjistruara, në vitin 2012, deri me datën 12.12.12 janë regjistruar 9201 biznese.

i. Turizmi dhe Rezervat Shtetërore

Departamenti i Turizmit ka vazhduar me licencimin e Agjencive Turistike dhe klasifikimi i objekteve hoteliere, me ç'rast janë licencuar 19 agjenci. Ndërkohë është arritur marrëveshje bashkëpunimi me Malin e Zi, në sferën e Turizmit.

Kosova tanimë ka për herë të parë rezervat e para shtetërore të grurit. Për më shumë, **është miratuar strategjia dhe programi vjetor për rezervat shtetërore.** Ndërkohë, MTI ka përgatitur listën finale të produkteve që konsiderohen si produkte të Rezervës Shtetërore të Mallrave si dhe caktimi i kriterëve për kufirin minimal dhe maksimal të Rezervës Shtetërore.

8. Ligjet

Aktivitetet e MTI-se gjatë vitit 2012 po ashtu kanë përfshirë reforma në legjislacion, me ç'rast janë përmirësuar dhe aprovuar në Kuvend:

1. Ligji për Metrologjinë,
2. Ligji për Metalet e Çmuara,
3. Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit,
4. Regjistrimin e Pengut në Regjistër,

Ndërsa në procedurë të ndryshimit e të cilat janë aprovuar në Qeveria janë:

1. Ligji për Zonat Ekonomike,
2. Ligji për Turizmin,
3. Ligji për Produktet e Ndërtimit, dhe Investimet e Huaja,

9. Planet dhe Objektivat për 2013

Me gjithë suksesin, MTI është e vetëdijshme për **sfidat për vitin e ardhshëm** të cilat përfshijnë mungesën e kapaciteteve administrative, pamundësinë buxhetore për te rekrutuar staf të ri si dhe sfidat përgjatë implementimit të plotë të strukturës së re organizative të MTI-së. **Planet e MTI-së për 2013 përfshijnë:**

- a) **Përmirësimin e ambientit të të bërit biznes** që nënkupton përmirësimin e mëtejshëm të pozicionit të të bërit biznes dhe mbrojtjen e investimeve. Qëllimi jonë për vitin 2014 që Kosova të jetë ndër 40 vendet më reformatore në indeksin e Bankës Botërore të të bërit biznes. Ne planifikojmë me vazhdimin e heqjes së lejeve dhe licencave dhe thjeshtësimin e procedurave për lëshimin e tyre.
- b) **Mbështetjen e NVM-ve dhe Promovimin e Investimeve** që nënkupton krijimin e një fondi të veçantë për përmirësimin e qasjes në financa për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Në këtë drejtim MTI do të punoj edhe për krijimin i **një mekanizmi financiar që lehtëson koston e bizneseve** (grante, huadhënie, garancinë për kredi, dhe hua te buta).
- c) Po ashtu MTI do të vazhdojë me funksionalizimin e mëtejshëm të 4 inkubatorëve ekzistues të biznesit dhe do të punojë në përafrimin e mëtejshëm me Aktin e Evropian të Bizneseve të Vogla dhe përmirësimin e klasifikimit të ndërmarrjeve.
- d) MTI do të **vazhdojë negocimin e Marrëveshjeve tjera për Promovim dhe Mbrojtje të Investimeve me vendet tjera**. Ne jemi në proces të draftimit të studimit të fizibilitetit në identifikimin e 5 industrive me avantazh konkurrues, po bëjmë promovimin e Pronësisë Industriale, si dhe jemi duke zhvilluar strukturat e bizneseve duke u koncentruar në zonat më pak të zhvilluara, krijimin e zonave industriale dhe hapjen e qendrave inovative dhe atyre për trajnime profesionale.
- e) **Përmirësimi i Politikave Tregtare** është një nga prioritetet e MTI-së për vitin e ardhshëm. Ne shpresojmë që të përfundojmë negociatat e Marrëveshjes së Tregtisë së Lire me Turqinë, të përmirësojmë kapaciteteve administrative, të zbatojmë legjislacionin e tregtisë dhe të përmirësojmë ligjin për antidumping dhe masa kundër balancuese. MTI planifikon të funksionalizojë plotësisht strukturat për draftim dhe koordinim të politikave tregtare si dhe të përmirësoj pozicionin e Kosovës përballë vendeve të CEFTA-së.

- f)** MTI ka për synim **përmirësimin e Lëvizjes së Lire të Mallrave** duke përfshirë zhvillimin e mëtejshëm të Infrastrukturës së Cilësisë. Kjo përfshinë funksionalizimin e mëtejshëm të Laboratorëve të Metrologjisë, mbikëqyrjen e trupave të vlerësimit të konformitetit, ngritjen e kapaciteteve administrative si dhe promovimin e përdorimit të standardeve
- g)** Po ashtu, **përmirësimi i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Mbrojtjes së Konsumatorit** është në planet tona. Përmirësimi i bashkëpunimit ndërinstitucional në mbikëqyrjen e tregut si dhe ngritja e vetëdijes së konsumatorit për mbrojtjen nga produktet e rrezikshme është e rëndësishme. Ne po punojmë edhe në zhvillimin e bazës së të dhënave për produktet e rrezikshme, konform RAPEX-it.